



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:136395
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05370066

A.nr.1676/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçi dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditëses I. K.. nga P.. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.. Sh., avokate nga P., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me palën e interesit O.. K.. C., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati Xh..T., për shkak të anulimit të vendimit me numër A-58/22 të datës 31.05.2022, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 05.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditëses I. K.. nga P.. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh..Sh., avokate nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi A-58/22 i datës 31.05.2022 i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, pa praninë e palës paditëse të ftuar në mënyrë të rregullt, e me praninë e palës së paditur dhe palës së interesit.

Paditësja me padinë e datës 04.07.2022, kërkon anulimin e vendimit të goditur me padi. Pohon se vendimi i shkallës së dytë nuk jep arsye dhe asnjë argument faktik e ligjor për refuzimin e ankesës së paditëses dhe askund nuk përmend fare e as nuk e shqyrton dhe as ekzaminon ankesën e paditëses në kufinj të ekzaminimit dhe kërkesës së saj. I propozon Gjykatës që të marr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi padia si e bazuar dhe anulohet vendimi i kontestuar i nxjerrë nga e paditura.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 13.03.2023 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se pretendimet ankimore të paditëses nuk qëndrojnë për shkak se kjo pjesë e parcelës nuk i përket të ankimuarës dhe e njëjta në shkresat e lëndës nuk ka prezantuar ndonjë provë për vendosje ndryshe nga organet komunale të Prishtinës me shkresën Nr.05-070/01-63164/22 të datës 21.03.2022, prandaj vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe i njëjti është lëshuar konform Planit Rregullues Urban “Mati 1” dhe Planit Zhvillimor Urban. I propozon Gjykatës që padinë ta refuzoj si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e të paditurës deklaroi: *“Duke kundërshtuar kërkesëpadinë paditësit vërtetojmë vendimin E atakuar me padi nga paditësi i cili është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që ka vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me caktimin e kushteve të ndërtimit të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit dhe i njëjti është lëshuar në bazë të dispozitave ligjore dhe planit të urbanizimit MATI 1 dhe planit Zhvillimor Urban, andaj pasi që kemi pranuar edhe ekspertizën e gjeodezisë dhe të arkitekturës të njëjtit kanë vërtetuar se objektet banesore janë ndërtuar nga Kompania “Orient Cubz construction”, janë të ndërtuara sipas lejes së ndërtimit me numër 05351/0270343/22 dhe janë të pozicionuara sipas dispozitave urbanistike duke e respektuar në këtë mënyrë vijën ndërtimore të paraparë sipas planit rregullativ Mati 1 dhe PZHU Prishtinë, po ashtu edhe eksperti i arkitekturës në ekspertizën e tij ka konstatuar se matjet nga gjeodeti, shqyrtimi i dokumentacionit sipas vendimit për kushte ndërtimore 06-350/01-121257/21 i dt.08.11.2021, dhe vendimi për leje ndërtimi 05nr.351/02-70343/22 dt.17.10.2022, janë në përputhje me planin rregullativ të Mati1 dhe PZHU Prishtinë. Pra nga kjo rrjedh se vendimi i atakuar me padi është i drejtë dhe i ligjshëm dhe ka vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, andaj i kërkojmë gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar dhe të të vërtetohet vendimi i atakuar me padi. Njoftoj gjykatën se nuk kam pyetje për ekspertët”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Në tërësi pranë deklarimeve të mëhershme dhe i propozoj gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar dhe të lërë në fuqi vendimin e atakuar me padi si të drejtë dhe të ligjshëm”.*

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i palës së interesit deklaroi: *“Nuk kam pyetje për ekspertë lidhur me ekspertizën e hartuar të tyre, njoftoj gjykatën se paditësja në këtë rast ka pranuar kushtet ndërtimore me dt.19.12.2023, dhe në bazë të këtyre kushteve është vërtetuar se mes palëve më nuk ka kontest sepse me pajtimin e vet palëve siç e vërteton edhe vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, pala veç se është pajtuar me vendimin e atakuar me padi këtu. Gjykatës ia dorëzoi në shikim vendimin për kushtet e ndërtimit të dt.18.12.2023, në të cilin bën pjesë edhe paditësja”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Qëndrojmë pranë deklarimeve të deri tanishme, dhe bazuar në provat e administruara si dhe ekspertizën e ekspertëve të caktuar nga gjykata me të cilën vërtetohet se vendimi i atakuar me padi por edhe ndërtimi i palës së interesit është në përputhje me PZHU, ndaj i propozojmë gjykatës që padinë paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe të vërtetoi vendimet e atakuara me padi”.*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi A-58/22 dt.31.05.2022, ankesa e dt.18.03.2022, shkresa e dt.28.03.2022, parashtrësia e lëndës 04.04.2022, certifikata me numër të lëndës 11-942/03-0131457/22 dt.09.06.2022, dhe kopja e planit dt.09.06.2022, kontrata noteriale për ndërtim të përbashkët me numër 9444/2021 dt.21.06.2021, shikohen 9 fotografi nga vend punimi vendimi për lejim të ndërtimit i K.K. Prishtine t.17.10.2022, ankesa e dt.14.11.2022, njoftimi i dt.20.10.2022, vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore i dt.08.11.2021, situacioni i parcelave në vijën ndërtimore i dt. 08.11.2021, procesverbali i dt.09.09.2021, ftesa e dt.16.08.2021, njoftimi publik i dt.25.06.2021, informim i dt.26.10.2022 dhe 24.11.2022, vendimi për hedhje poshtë të ankesës dt.12.10.2022, kërkesa për fillim të hetimeve e dt.23.02.2023, ekspertiza gjeodezike 09.11.2023 dhe e Arkitekturës dt.17.11.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e të paditurës është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Gjykata gjeti se e paditura ka marrë vendim në përputhje me ankesën e paditësit dhe vendimi i shkallës së dytë i përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditësja as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për ti mbështetur pohimet e saj të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës është shkelur ndonjë dispozitë ligjore në dëm të paditësit.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë aktvendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrahi arsyetimin e të paditurës të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar se lidhur me parcelën nr.637-6 ZK Matiçan e ankimuar nga pala I. K., është në emër të G.. A.. nga P..dhe e njëjta gjendet brenda Bllokut D-I-B, me destinim aktual rrugë-gjysma e aksit rrugor, por sipas PRRU "Mati 1", është me destinim ndërtim i lartë dhe i mesëm mix, poashtu Investitori posedon Kontratën e vërtetuar me Aktin Noterial Nr.LRP.9444/2021 të datës 21.06.2021 për Ndërtimin e Përbashkët dhe Rregullimin e Raporteve Pronësore, andaj pretendimet e paditëses, gjykata i refuzoi si të pabazuara duke marrë për bazë faktin se kjo pjesë e parcelës nuk është dëshmuar ti përkas paditëses dhe se nuk ekziston asnjë bazë ligjore mbi të cilën do të mund të aludohej në anulimin e Vendimit Nr.05.Nr.350/02-121257/21 të datës 08.11.2021 për caktimin e kushteve ndërtimore, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Prishtinës për Palën e Interesit Investitorin Orient Kubz Construction”, sh.p.k.

Gjykata refuzoi provën e paditëses të quajtur “Raport Inxhinierik” i Shkurtit 2023, për faktin që të njëjtës i mungojnë elementet esenciale të provës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në

atë se kësaj prove i mungon autori apo autorët, licenca apo licensat e nevojshme të cilat do ta bënin kredibile cilësimin e saj si provë, nuk ka nënshkrim dhe as vulë as personale dhe as të ndonjë subjekti të autorizuar për hartimin e këtij Raporti.

Gjykata poashtu refuzoi provën e paditëses, përkatësisht Kërkesën për fillimin e Hetimeve, për faktin që vlerësimi i pretendimeve penale në lidhje me përgjegjësinë penale të subjekteve të apostrofuara në këtë kërkesë, nuk është në përgjegjësinë e kësaj gjykate në këtë konflikt administrativ, por vetëm vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit përfundimtar të nxjerrë në procedurë administrative.

Mbi këtë bazë, gjykata e pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës ndaj ankesës së palës dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata poashtu i falë besimin e plotë ekspertizës gjeodezike nga eksperti Luan Islami i cili ka konstatuar se objektet banesore të ndërtuara nga kompania “Orient Kubz Construction” SH.P.K. janë të ndërtuara konform lejes ndërtimore 05-351/02-70343/22 dhe janë të pozicionuara sipas dispozitave urbanistike duke e respektuar në këtë mënyrë vijën ndërtimore të paraparë sipas planit rregullues “Mati 1” & PZHU-së Prishtinë. Gjykata poashtu i falë besimin e plotë edhe ekspertizës nga arkitektura e ekspertit gjyqësor Hekuran Rugova, i cili ka konstatuar se vendimi për kushte ndërtimore 05-350/01-121257/21 i datës 08.11.2021 dhe vendimi për leje ndërtimore 05 nr.351/02-70343/22 i datës 17.10.2022 janë në përputhje me planin rregullues Mat 1 dhe PZHU.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i kanë provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata përfundimisht konstatoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1676/2022, datë: 05.02.2024

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.